



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:276820
Datë: 31.01.2024
Numri i dokumentit: 05266574

A-REV.nr.1/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit R. M. nga M..., sipas autorizimit e përfaqëson avokat Ethem Rogova nga P. kundër të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, me bazë juridike anulim i aktit administrativ të organit të paditur, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga paditësi, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.577/2022, të datës 20.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 24 Janar 2024, merr:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë si i palejuar revizioni, i parashtruar nga paditësi R. M. nga M..., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.577/2022, të datës 20.11.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 672/18, të datës, 11.02.2022, **Refuzohet** padia e paditësit, R. M., nga M..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet Vendimi nr. 0741-720, datë 21.02.2019, dhe të detyrohet e paditura që në emër të kompensimit për subvencion të grurit, ti paguaj paditësin shumën prej 17,122.50€uro, **si e pa bazuar**.

Duke vendosur në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit si më lartë të shkallës së parë, Gjykata e Apelit-Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin, AA.nr.577/2022 të datës 20.11.2023, të kontestuar me revizion, e refuzon si të pa bazuar ankesën e ankuesit R.M. nga M., ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 672/18, të datës, 11.02.2022 e vërteton.

Kundër aktvendimit si më lartë të Gjykatës së Apelit, paditësi në Gjykatë Supreme për mes përfaqësuesit me prokurë avokat Ethem Rogova parashtron revizion, me të cilin e konteston

ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të Procedurës Kontestimore-neni 181.1 a), lidhur me nenin 182.2 n) të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale- nenin 181.1 c), lidhur me nenin 184 LPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin e paditësit R. M. nga M., të anuloj aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AA nr. 577/2022 të datës 20.11.2023 dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe vendosje.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se;

Revizioni i paraqitur është i palejuar.

Sipas Nenit 24, të Ligjit për Konfliktet Administrative, (LKA), parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrihet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishin ndikim në zgjidhjen e çështjes.*

Sipas Nenit 25 të LKA, parashihet se, *kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtrijë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.*

Sipas nenit 50, parag.1, të LKA, parashihet, *” kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Sipas parag.2, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa ”.*

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitave të cituara të Ligjit për Konflikte Administrative kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se, me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë të Departamentit për Çështje Administrative të gjykatës së shkallës së dytë, prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e paditësit si të palejuar.

Nga parashtrimet si më lartë dhe në kuptim të nenit 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË
A.REV. nr. 1/2024, datë 24 Janar 2024

Bashkp. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani